



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 59

Tiranë – E hënë, 27 mars 2017

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 20.3.2017	3417
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 20.3.2017	3421
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 22, datë 20.3.2017	3426
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 20.3.2017	3430

Vendim i Gjykatës Kushtetuese  
nr. 24, datë 23.3.2017

Me objekt: shfuqizimin e nenit 2/1/a, nenit 2/2, nenit 4, pikat 1, 5, 6 dhe 7, i fjalëve “moszgjedhje” në nenin 10 dhe i shkronjës “d”, neneve 14 dhe neni 15 për funksionarin publik kryetar i bashkisë, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

Shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 952, datë 29.12.2016, “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, zoti Elvis Rroshi”;

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 174, datë 29.12.2016, “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik, z. Elvis Rroshi, Kryetar i Bashkisë Kavajë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

Shqyrtimin e kushtetutshmërisë së të gjithë ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” .....



**VENDIM**  
**Nr. 20, datë 20.3.2017**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË**  
**SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,  
 e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 15.11.2016,  
 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë  
 dokumentesh, çështjen nr. 71/11 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Lemontov Gjoka

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Avokatura  
 e Shtetit, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të  
 Pronave Tiranë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të  
 Paluajtshme Tiranë

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtueshëm me  
 Kushtetutën i vendimit nr. 478, datë 11.11.2015 të  
 Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 42/2, 131/f e  
 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së  
 Shqipërisë; nenet 27 e në vijim të ligjit nr. 8577,  
 datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin  
 e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Besnik Imeraj,  
 mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të  
 kërkuesit, që është shprehur për pranimin e  
 kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar,  
 Avokaturës së Shtetit, që ka kërkuar rrëzimin e  
 kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuesi Lemontov Gjoka i është drejtuar  
 Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave  
 Tiranë, duke kërkuar “tjetërsimin e pronës së  
 poseduar si oborr në përdorim në lidhje  
 funksionale me banesën e ndodhur në rrugën  
 “Marko Boçari”, Tiranë dhe kalimin në pronësi me  
 shpërblim të këtij trualli oborr në përdorim me  
 sipërfaqe 42.4 m<sup>2</sup>”, duke u bazuar në ligjin nr. 9235,

datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e  
 pronës”, të ndryshuar dhe në VKM-në nr. 200, datë  
 19.2.2009, “Për *caktimin e kushteve dhe për procedurën e  
 tjetërsimit të oborreve në përdorim për llogari të fondit të  
 kompensimit*”.

2. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të  
 Pronave Tiranë, me vendimin nr. 40, datë 21.1.2010,  
 pasi ka shqyrtuar edhe dokumentacionin  
 bashkëngjitur kësaj kërkesë, e ka pranuar atë duke  
 vendosur: “*Pranimin e kërkesës. Tjetërsimin e sipërfaqes  
 42.4 m<sup>2</sup> të ndodhur në rrugën “Marko Boçari”, Tiranë dhe  
 kalimin në pronësi me kundërshtëpërblim të saj në favor të  
 subjektit Lemontov Gjoka. Këtij vendimi i bashkëngjitet  
 planvendosja sipas shkrimeve konvencionale përkatëse...*”.

3. Ky vendim i është dërguar Zyres së  
 Avokaturës së Shtetit, e cila, duke pretenduar se  
 personi i tretë nuk i përmbush kriteret e  
 parashikuara në VKM-në nr. 200, datë 19.2.2009,  
 “Për *caktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të  
 oborreve në përdorim për llogari të fondit të kompensimit*”, i  
 është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e  
 mosmarrëveshjes.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me  
 vendimin nr. 1510, datë 1.3.2011, ka rrëzuar  
 kërkesëpadinë nr. 1494 Akti të datës 26.2.2011.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 512,  
 datë 8.3.2012, ka lënë në fuqi vendimin nr. 1510,  
 datë 1.3.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin  
 nr. 478, datë 11.11.2015, ka ndryshuar vendimin nr.  
 1510, datë 1.3.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor  
 Tiranë dhe vendimin nr. 512, datë 8.3.2012 të  
 Gjykatës së Apelit Tiranë duke pranuar  
 kërkesëpadinë dhe duke shfuqizuar vendimin nr. 40,  
 datë 21.1.2010 të AKKP-së Tiranë.

**II**

7. **Kërkuesi Lemontov Gjoka** i është drejtuar  
 Gjykatës Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e  
 procesit të rregullt ligjor për shkaqet e mëposhtme:

7.1 *Është cenuar standardi kushtetues i gjykimit nga një  
 gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka bërë  
 një vlerësim provash të ndryshëm nga ai i gjykatave  
 të faktit dhe pala paditëse gjatë gjykimit nuk ka  
 provuar ndonjë parregullsi për sa i përket paraqitjes  
 së dokumentacionit apo shqyrtimit të kësaj kërkesë.

7.2 *Është cenuar standardi i barazisë së armëve dhe  
 kontradiktoritetit*, pasi me anë të kësaj vendim-marrjeje  
 kërkuesi është vënë në pozitë të disfavorshme në  
 raport me palën tjetër.



7.3 Është cenuar parimi i aksesit në gjykatë dhe standardi i arsytimit të vendimit, pasi kërkuesi pretendon se nga shqyrtimi i vendimit objekt kërkese nga Gjykata e Lartë nuk i janë krijuar të gjitha mundësitë për të paraqitur pretendime apo për të kundërshtuar palën tjetër. Gjithashtu, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk paraqet forcë argumenti ligjor, qartësi interpretimi mbi të cilat mbështet vendimmarrja, duke shkëlur në këtë mënyrë kufijtë e shqyrtimit nga ana e saj.

7.4 Është cenuar siguria juridike, pasi pala që i drejtohet Gjykatës ka detyrimin procedural “onus probandi” që të paraqesë argumentet dhe provat mbi bazën e të cilave mbështet pretendimet e saj.

8. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, ka parashtruar sa vijon:

8.1 Nga certifikatat e pronësisë rezulton se kërkuesi është pronar i një apartamenti dhe jo i sipërfaqes së truallit rreth e qark ndërtesës.

8.2 Libri i ngastrave nuk garanton gjendjen juridike lidhur me pronësinë për një pasuri të caktuar.

8.3 Sipërfaqja që kërkohet të tjetërsohet nga z. Lemontov Gjoka është një sipërfaqe funksionale e rrugës dhe që i përgjigjet një interesi publik.

8.4 Në rastin në shqyrtim nuk rezulton që Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë të ketë administruar ndonjë provë të re apo të ketë bërë një rivlerësim të provave të administruara në gjykimet e faktit.

8.5 Kërkuesi ka pasur të drejtën e ushtrimit të ankimit dhe të rekursit.

9. **Subjektet e interesuara, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajt-shme Tiranë** nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

10. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës. Po ashtu, ai legjitimohet *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afati 2-vjeçar të përcaktuar në nenin 30 të ligjit, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/2 të Kushtetutës, pasi pretendimet e ngritura në kërkesë për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe të

parimit të sigurisë juridike janë të tilla që *prima facie* i përkasin juridiksionit kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

12. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë ka cenuar standardin kushtetues të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, duke bërë një vlerësim provash të ndryshëm nga ai që është arritur nga gjykatat e faktit.

13. Kërkuesi duke pretenduar se është subjekt i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 200, datë 19.2.2009, “Për përcaktimin e kushteve dhe për procedurën e tjetërsimit të oborreve në përdorim për llogari të fondit të kompensimit financiar”, në zbatim të përcaktimeve të këtij akti normativ, i është drejtuar Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave me kërkesë për tjetërsimin me kundërshtpërblim të sipërfaqes “oborr në përdorim” dhe kalimin në pronësi të tij të truallit nën ndërtim dhe oborrit funksional duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës.

14. Dokumentacioni i marrë në shqyrtim nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është konsideruar se plotëson kushtet ligjore për tjetërsimin e oborrit në përdorim duke iu pranuar kërkesa personit të tretë. Në të njëjtin konkluzion kanë arritur edhe gjykatat e faktit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka çmuar se arsyetimi dhe konkluzionet e nxjerra nga gjykatat e faktit janë të gabuara dhe të pambështetura në ligj e në akte nënligjore.

15. Shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë e caktuar me ligj është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 32, datë 25.5.2015; nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës,



Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në të drejtën procedurale civile kufijtë brenda të cilëve Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë shqyrton çështjet për rekursin e ushtruar janë parashikuar në nenet 472 dhe 485 të KPC-së. Sipas nenit 472 të KPC-së, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka në kompetencë të shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, kurse neni 485 i KPC-së i ka dhënë të drejtë Kolegjit Civil apo Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që, ndër të tjera, të vendosin prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe të lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojnë njëkohësisht vendimet e të dyja gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtësi të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar gjatë gjykimit në fakt (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Nga analiza e vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat e faktit nuk e kanë pranuar padinë e ngritur nga Avokatura e Shtetit, duke arsyetuar se dokumentacioni i marrë në shqyrtim nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave konsiderohet se plotëson kushtet ligjore për tjetërsimin e oborrit në përdorim, duke iu pranuar kërkesa personit të tretë, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij ka qenë i plotë dhe në përputhje me ligjin. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar:

*“Vendimi nr. 40, datë 21.1.2010 i AKKP-së Tiranë është i kundërligjshëm, pasi nuk ka respektuar kriteret e VKM nr. 200, datë 19.2.2009 dhe se tjetërsimi në këtë rast bie ndesh me interesin publik (ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, neni 7), e në këto kushte padia e palës paditëse që ka kërkuar anulimin e tij është e bazuar [...] se arsyetimi dhe konkluzionet e nxjerra nga gjykatat e faktit janë të gabuara dhe të pambështetura në ligj dhe në aktet nënligjore. Kolegji Civil çmon se gjykatat nuk kanë bërë një cilësim të drejtë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, në përputhje me nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, dhe nuk kanë marrë në vlerësim e analizë kriteret ligjore për tjetërsimin e oborreve në përdorim, sikundër parashikohen në dispozitat e ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 dhe VKM nr. 200, datë 19.2.2009, duke konkluduar në bazë të analizës së provave se këto kritere plotësohen”.*

19. Gjykata vlerëson se nëse Gjykata e Lartë do të kishte dyshime në lidhje me vlefshmërinë e dokumentacionit dhe të kriterëve, ajo duhej ta kthente çështjen për rigjykim, në përputhje me kompetencat e saj të parashikuara në ligji. Ajo në asnjë rast nuk mund ta zgjidhë vetë çështjen në themel, duke rivlerësuar ndryshe faktet dhe provat e marra gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë. Një veprim i tillë bie ndesh me parimin e gjykatës së caktuar me ligj të zhvilluar nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj. Për më shumë që gjykatat e faktit nuk kanë marrë në shqyrtim faktin se prona objekt shqyrtimi është afër rrugës kryesore, fakt ky i vënë në dukje nga Gjykata e Lartë.

20. Gjykata rithekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 83, datë 30.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Bazuar në standardet e mësipërme dhe rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar tej kompetencave të tij ligjore, duke cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si një nga elementet e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Gjyqtari V. Kristo votoi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, edhe për shkak se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke vendosur pranimin e kërkesëpadisë i ka atribuar vetes kompetenca të paautorizuara nga ligjvënësi.



22. Sipas kërkuesit është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar lidhur me shkaqet e rekursit dhe objektin e kërkimeve të parashtruar në të.

23. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 2, datë 26.1.2015; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 20, datë 13.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Nga rrethanat e çështjes konkrete Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë përmban rrethanat e çështjes konkrete, disponimet e gjykatave të faktit, ligjin e zbatueshëm, si dhe arsyetimin në lidhje me zbatimin e ligjit në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Nga përmbajtja e vendimit rezulton se, “Për sa arsyetuar më lart, Kolegji arrin në konkluzionin se vendimi nr. 40, datë 21.1.2010 i AKKP-së Tiranë është i kundërligjshëm, pasi nuk ka respektuar kriteret e VKM nr. 200, datë 19.2.2009 dhe se tjetërsimi në këtë rast bie ndesh me interesin publik (ligjin nr. 9235, datë 29.7.2004, neni 7), e në këto kushte padia e palës paditëse që ka kërkuar anulimin e tij është e bazuar”.

27. Gjykata e Lartë i është referuar hartës treguese të regjistrimit, si dhe planvendosjes së pronës, duke konkluduar se prona objekt shqyrtimi është një sipërfaqe funksionale e rrugës dhe për këtë arsye i përgjigjet një interesi publik.

28. Gjykata konstaton se ky fakt nuk është arsyetuar, vënë në bisedim apo shqyrtuar nga gjykatat e faktit.



29. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në kërkesë, Gjykata vlerëson se ato në thelb lidhen me vlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, duke tejkaluar juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. dhe Për këtë arsye duhet të rrëzohen si haptazi të pabazuara.

30. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se në Gjykatën e Lartë është zhvilluar një proces i parregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, si rrjedhojë e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 478, datë 11.11.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtare kundër: Altina Xhoxhaj

#### VENDIM

**Nr. 21, datë 20.3.2017**

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Besnik Imeraj	anëtar i “ “
Fatos Lulo	anëtar i “ “
Gani Dizdari	anëtar i “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 18.1.2017,

mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 87/23 Akti, që i përket:

KËRKUES: Gentian Kaçi

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 5, datë 10.1.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 90, datë 17.6.2014 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2014-1861, datë 20.11.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 16, 17/2, 31/d, 42, 43, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pikat 1 dhe 3/d të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

#### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të përfaqësuesit të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

#### VËREN:

#### I

1. Me vendimin e datës 11.4.2012 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për ngjarjen aksidentale me pasojë vdekjen e shtetasit A.K. Nëpërmjet shërbimit postar ky vendim i është njoftuar babait të viktimës, shtetasit Gentian Kaçi (*kërkuar*).

2. Në datën 24.9.2012 kërkuar i është drejtuar gjykatës për kundërshtimin e vendimit të mësipërm të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal. Me vendimin nr. 5, datë 10.1.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka vendosur rrëzimin e kërkesës, pasi është paraqitur jashtë afatit 5-ditor të parashkrimit.

3. Me vendimin nr. 90, datë 17.6.2014, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 5, datë 10.1.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Kundër këtij vendimi kërkuar ka paraqitur rekurs.

4. Me vendimin nr. 00-2014-1861, datë 20.11.2014, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e



rekursit të paraqitur, për arsye se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

## II

5. **Kërkuesi Gentian Kaçi** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1 *Është cenuar parimi i barazisë së armëve dhe i kontradiktoritetit në gjykim*, pasi kërkuesi është vënë në pozitë të disfavorshme përballë akuzës. Ai nuk ka pasur dijeni për vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe është vënë në dijeni për të pasi ka kërkuar informacion me shkrim nga ana e organit të akuzës. Nga momenti që i është vënë në dispozicion ky vendim kërkuesi i është drejtuar me kërkesë gjykatës për kundërshtimin e tij. Në gjykim ai kërkoi që të thirrej si dëshmitar nëpunësi i postës që ka bërë komunikimin e vendimit, si dhe të kryhej një akt ekspertimi grafik për shënimet e vendosura në librin e postës, nga i cili do të provohej se këto shënime nuk janë bërë nga kërkuesi, kërkesa që nuk u pranuan nga gjykata e shkallës së parë. Ky parim është cenuar edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila nuk përsëriti pjesërisht hetimin gjyqësor për të marrë provat e kërkuara nga kërkuesi.

5.2 *Është cenuar e drejta e aksesit*, pasi gjykatat i kanë mohuar kërkuesit të drejtën për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij. Kjo e drejtë është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit, pa u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në të.

5.3 *Është cenuar parimi i paanshmërisë*, pasi gjyqtari që ka gjykuar çështjen në gjykatën e shkallës së parë e ka paragjykuar atë, çka u konstatua nga mospranimi i kërkesave të paraqitura nga kërkuesi gjatë gjykimit. Duke qenë se ky gjyqtar nuk ofronte garancitë e nevojshme për të dhënë drejtësi, kërkuesi kërkoi përjashtimin e tij, kërkesë që nuk u pranua nga kryetari i gjykatës.

6. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka prapësuar me shkrim para Gjykatës në mënyrë të përmbledhur sa më poshtë vijon:

6.1 Pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve, për shkak të rrëzimit të kërkesës për kryerjen e ekspertimit grafik dhe thirrjen e dëshmitarit, është i pabazuar. Kërkuesi e ka

ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe pas shqyrtimit të akteve gjykata ka konstatuar se ai është paraqitur jashtë afatit ligjor. Ky vendim është kundërshtuar nga kërkuesi edhe në shkallët e tjera të gjykimit, pa iu mohuar e drejta e ankimit.

6.2 Në lidhje me pretendimin se nuk është njoftuar për vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, rezulton se kërkuesi është njoftuar në përputhje me nenet 132/1, 137/1 dhe 140/1 të KPP-së. Njoftimi nga ana e Prokurorisë është bërë në adresën e banimit të kërkuesit nëpërmjet shërbimit postar dhe e konfirmuar prej këtij shërbimi. Në të njëjtën adresë është dërguar nga gjykata e shkallës së parë edhe njoftimi për zhvillimin e gjykimit dhe rezulton se në këtë rast kërkuesi ka marrë dijeni. Mënyrat e ndryshme të nënshkrimit në librat e dorëzimit të postës nuk mund të hedhin dyshime mbi vërtetësinë e faktit të dorëzimit të vendimit, ndaj pretendimet për ekspertimin e nënshkrimeve janë të pavenda dhe nuk mund të zbehin këtë fakt.

6.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim. Nga ana e kërkuesit dhe mbrojtësit të tij në momentin e njohjes me gjyqtarin e çështjes nuk ka pasur kundërshtime në lidhje me këtë. Fakti se gjyqtari nuk ka pranuar kërkesat gjatë gjykimit nuk do të thotë se ai ka paragjykuar çështjen. Vendimet e ndërmjetme të dhëna prej gjyqtarit nuk janë të tilla që të vënë në dyshim paanshmërinë e tij. Po ashtu, ky pretendim është ngritur nga kërkuesi edhe në Gjykatën e Apelit, e cila i ka dhënë përgjigje të arsyetuar në vendimin e saj.

## III

### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij *prima facie* janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.





*B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve*

8. Sipas kërkesit, gjykata e shkallës së parë ka cenuar parimin e barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit në gjykim, pasi nuk ka pranuar kërkesat e paraqitura për thirrjen si dëshmitar të nëpunësit të postës, i cili ka bërë komunikimin e vendimit, dhe për kryerjen e aktit të ekspertimit grafik për shënimet e vendosura në librin e postës. Sipas tij, ky parim është cenuar edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, e cila nuk ka përsëritur pjesërisht hetimin gjyqësor për të marrë provat e kërkuara nga kërkuesi.

9. Gjykata ka theksuar se parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohej thjesht prania fizike gjatë procesit, por, përkundrazi, duhet që legjislacioni procedural më parë dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëjës palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklaramit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 28, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në jurisprudencën kushtetuese është evidentuar dallimi që ekziston ndërmjet mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në një proces gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vlerësimi, dobishmëria dhe rëndësia e tyre provuese në një çështje konkrete është, si rregull, detyrë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ndërsa verifikimi i ligjshmërisë së krijimit dhe marrjes së provave i nënshtrohet edhe kontrollit të Gjykatës, pasi ky aspekt i gjykimit ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e rregullt

ligjor. Gjykata mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për rrugën e mënyrën e marrjes dhe fiksimit të provave, por jo të vlerësimit të tyre. Marrja e provave, paraqitja dhe vlerësimi i tyre, është në juridiksion të gjykimit të zakonshëm dhe jo atij kushtetues. Është vetë gjykata e zakonshme që vlerëson nëse provat duhet të merren dhe mënyra e vlerësimit dhe konkluzionet lidhur me to janë po ashtu në kompetencë të saj (*shih vendimin nr. 9, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, parimi i barazisë së armëve nuk u imponon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që këto të pranojnë të gjitha argumentet dhe provat që paraqet një palë në proces. Kur kryen detyrën e saj të vlerësimit të lirë të provave, gjykata mund të bindet mbi bazën e disa provave, duke përjashtuar një ose disa prova të tjera, që ajo i konsideron të parëndësishme për çështjen (*shih vendimin nr. 19, datë 19.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi, vëren se kërkuesi i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë në datën 25.9.2012 për kundërshtimin e vendimit të Prokurorisë të datës 11.4.2012 për mosfillimin e procedimit penal. Në gjykim është pretenduar se kërkuesi ka marrë dijeni për vendimin pasi ka bërë kërkesë pranë Prokurorisë dhe se nuk i është njoftuar ky vendim me anë të shërbimit postar, siç pretendohet dhe rezulton nga vërtetimi i paraqitur në gjykim, i lëshuar nga Drejtoria e Postës Shqiptare. Për këtë arsye, në seancën gjyqësore të datës 6.12.2012, është kërkuar që të thirret si dëshmitar nëpunësi që ka bërë dorëzimin e vendimit, të administrohet regjistri i shënimeve, si dhe të kryhet një akt ekspertimi grafik për nënshkrimin që ndodhet në regjistrin e dorëzimit. Këto kërkesa janë rrëzuar nga gjykata me argumentin se marrja dijeni për vendimin e mosfillimit provohet me vërtetimin e datës 6.12.2012 dhe se kërkesa për kryerjen e ekspertimit grafik nuk është objekt i këtij gjykimi. Këto pretendime janë ngritur nga kërkuesi edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila i ka rrëzuar ato, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar në vendimin e saj.

12. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjykata ka marrë të gjitha masat për njoftimin e duhur të kërkesit për procesin dhe i ka dhënë mundësinë atij që të jetë i pranishëm në gjykim, të paraqesë provat dhe argumentet e tij në



mbështetje të kërkesës, të paraqesë kërkesat e tij para gjykatës, si dhe të kundërshtojë e mbrohet kundër pretendimeve të palës tjetër në gjykim. Vetëm fakti se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit nuk kanë pranuar kërkesat për marrjen e provave të kërkuara nga kërkuesi nuk është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim respektimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim. Në vlerësimin e Gjykatës nuk rezulton që gjykatat e faktit ta kenë vënë kërkuenin në pozita të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, për sa kohë që i kanë marrë në shqyrtim pretendimet e paraqitura prej tij në gjykim, duke u dhënë atyre përgjigje të arsyetuar.

#### C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit

13. Kërkuesi pretendon cenimin e së drejtës së aksesit, pasi gjykatat i kanë mohuar atij të drejtën për të pasur një përgjigje përfundimtare për pretendimet e tij. Sipas tij, kjo e drejtë është cenuar edhe nga Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit pa u dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në të.

14. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirisë dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjor, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur

individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato shkaqe që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit nuk është një shkelje e së drejtës së palëve për t'iu drejtuar gjykatës, por një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimin nr. 8, datë 26.2.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata vlerëson se në rekurs palët përpiqen të ngrenë para Gjykatës së Lartë shkaqe nga ato të parashikuara nga dispozitat procedurale përkatëse. Për këtë arsye, shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por një vlerësim i këtyre shkaqeve dhe i bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rastet kur Kolegji konstaton se shkaqet, pavarësisht nga mënyra e paraqitjes së tyre, kanë të bëjnë me vlerësimin e provave, bindjen e brendshme të gjykatave të shkallëve më të ulëta apo me shkaqe që objektivisht nuk ekzistojnë në dosjen gjyqësore, ka të drejtë të mos e pranojë rekursin. Kjo është edhe përgjigja që i jep Gjykata e Lartë pretendimeve të ngritura në rekurs nga palët (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar. Gjykata rithekson se kërkuetit gjatë procesit të zhvilluar në gjykatat e faktit i është dhënë mundësia që të paraqesë argumente dhe prova në mbështetje të pretendimeve të tij, për të cilat ka marrë përgjigje të



arsyetuar nga gjykatat. Po ashtu, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e tij ligjore, pasi ka marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në rekurs, i ka dhënë përgjigje kërkuarit lidhur me to, se nuk janë të tilla nga ato që parashikon neni 432 i KPP-së. Kërkuari e ka ushtruar lirisht të drejtën e aksesit në Gjykatën e Lartë nëpërmjet paraqitjes së rekursit, por kjo e drejtë nuk presupozon që gjykata duhet ta kalojë çështjen në seancë ose të pranojë kërkimet e palëve në çdo rast. Për pasojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e së drejtës së aksesit është i pabazuar.<sup>2</sup>

*Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë në gjykim*

18. Kërkuari pretendon cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, për arsye se gjyqtari që ka gjykuar çështjen në gjykatën e shkallës së parë e ka paragjykuar atë, pasi nuk ka pranuar kërkesat e paraqitura në gjykim për administrimin e disa provave.

19. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, sanksionuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata duhet të jetë e kujdesshme dhe të marrë parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Në shtetin e së drejtës kërkesa për një gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimin nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

<sup>2</sup> Gjyqtari V. Kristo votoi për cenimin e së drejtës së aksesit pasi gjykatat, në kushtet kur prokurori në apel ka pranuar se pretendimet e kërkuarit janë të bazuara, duhet të bënin të gjitha përpjekjet për ta realizuar këtë të drejtë ose duke kryer aktin e ekspertimit grafik, ose duke e rivendosur në afat kërkuarin.

20. Kur shqyrtohet nëse në një çështje të caktuar ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar se një gjyqtar i caktuar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që pretendojnë lidhur me mungesën e paanshmërisë së tij është rëndësishëm, por jo vendimtar. Vendimtar mbetet përcaktimi nëse dyshimi për paanshmërinë është objektivisht i justifikueshëm. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se edhe në rastin konkret paanshmëria e gjyqtarit duhet të vlerësohet në aspektin subjektiv dhe në atë objektiv. Për sa i takon paanshmërisë personale (subjektive) të gjyqtarit që ka shqyrtuar çështjen në gjykatën e shkallës së parë, pra bindjes së brendshme të tij për mënyrën e zgjidhjes së çështjes, nuk rezulton që kërkuari të ketë paraqitur ndonjë provë për të vërtetuar këtë pretendim. Mënyra e vlerësimit të provave të administruara në gjykim nga ana e gjyqtarit apo mënyra e interpretimit dhe zbatimit të ligjit jo vetëm që janë çështje që nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues, por ato nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin për paanshmëri.

21. Për sa i përket paanshmërisë objektive duhet shqyrtuar nëse objektiviteti i dyshimit të ngritur nga kërkuari është mjaftueshëmrisht i provueshëm dhe ky përfundim varet nga rrethanat e çështjes konkrete. Gjykata vlerëson se edhe në këtë drejtim nuk ka vend për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarit të çështjes. Veprimet e kryera prej tij jo vetëm që gjejnë pasqyrim në aktet e dosjes gjyqësore, por ai ka argumentuar edhe qëndrimin e tij për mospranimin e kërkesave të paraqitura në gjykim për thirrjen e dëshmitarit dhe kryerjen e aktit të ekspertimit. Në vlerësimin e Gjykatës mospranimi i këtyre kërkesave nuk është i mjaftueshëm për të konkluduar mbi anshmërinë e gjykatës në shqyrtimin e kësaj çështjeje dhe kërkuari nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër për të mbështetur këtë pretendim.

22. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuarit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të pabazuara, për rrjedhojë kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe



funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,<sup>3</sup>

**VENDOSI:**

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo

**VENDIM**

**Nr. 22, datë 20.3.2017**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 3.11.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 64/6 Akti, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Shoqëria “Gener 2” sh.p.k.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Bashkia Tiranë, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)

**OBJEKTI:** Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjyqimit brenda një afati të arsyeshëm, përcaktuar në ligjin nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjyqimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42/2, 134/1/i e 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 e 13 të KEDNJ-së.

<sup>3</sup> Gjyqtare V. Tusha pajtohet me vendimin e shumicës për rrëzimin e kërkesës, por në lidhje me shkakun e rrëzimit, siç është shprehur edhe më parë, ajo vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet për shkak të mosshterimit të mjeteve për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, që janë shprehur për rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Shoqëria “Gener 2” sh.p.k. është pajisur me vendimin nr. 9967/7, datë 1.8.2014 të kryetarit të Bashkisë Tiranë, “Për miratimin e lejes zhvillimore ndërtim” për strukturë banimi dhe shërbimesh 1 deri 17 kate, si dhe dokumentet e vendimet tjera të lejes përkatëse. Ky objekt ndodhet në rrugën “Kristo Luarasi” (pranë Digës së Liqenit Artificial Tiranë). Rezulton se Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) ka hapur proces gjyqësor në Gjykatën Administrative Tiranë me objekt: konstatimin e pavlefshmërisë absolute të akteve të kryetarit të Bashkisë Tiranë, si dhe marrjen e masës së sigurimit, atë të pezullimit të punimeve.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. Akti 3282, datë 7.4.2015, ka rrëzuar kërkesën për pezullimin e lejes së zhvillimit dhe pezullimin e punimeve.

3. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, me vendimin nr. 28, datë 18.6.2015, ka ndryshuar vendimin nr. Akti 3282, datë 7.4.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar kërkesën për marrjen e masës për sigurimin e objektit të padisë, si dhe duke urdhëruar pezullimin e punimeve të ndërtimit në zbatim të aktit administrativ vendimit të kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 9967/13, datë 14.10.2014.

4. Me vendimin nr. 2502, datë 11.5.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë, duke i konsideruar të gjitha aktet e nxjerra nga pushteti vendor në përputhje me legjislacionin e fuqi.

5. Rezulton se pranë Gjykatës së Apelit Administrativ është regjistruar çështja e themelit me palët objekt i këtij gjykimi pranë kësaj gjykate në datën 8.9.2015.



## II

6. **Kërkuesja, shoqëria “Gener 2” sh.p.k.**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar cenimin e parimit të mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, duke parashtruar sa më poshtë:

6.1 Gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit është shkëlur dhe vazhdon të shkelet neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së për gjykimin e çështjes në një kohë të arsyeshme.

6.2 Gjykata duhet ta kishte gjykuar çështjen brenda 30 ditësh nga ardhja e ankimit.

6.3 Referuar parashikimeve të ligjit nr. 49/2012 ligjvënësi ka vendosur afate kohore të caktuara dhe gjykata është e detyruar t'i zbatojë ato. Rezulton se çështja është caktuar për gjykim në dhomën e këshillimit në datën 11.5.2016 dhe aktualisht vazhdon të jetë pezull.

6.4 Janë zhvilluar disa seanca gjyqësore me shtyrje pa u kryer veprime, përkatësisht në datat 13.5.2015, 19.5.2015 dhe 25.5.2016, por aktualisht dosja mbahet pa asnjë veprim, pa asnjë shkak të arsyeshëm, ndonëse ishte planifikuar për t'u gjykuar dhe ishte ndryshuar relatori i kësaj çështjeje.

6.5 Mosrespektimi i këtyre afateve ligjore në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke sjellë mosgjykimin e çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesi brenda një afati të arsyeshëm, ka cenuar të drejtën e kërkuesit për një proces të rregullt ligjor.

7. **Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë**, ka parashtruar si vijon:

7.1 Pretendimet e kërkuesit nuk qëndrojnë, pasi çështja objekt gjykimi është një nga shumë çështjet që janë në radhë pritjeje në Gjykatën e Apelit Administrativ.

7.2 Shtyrja e kësaj çështje është bërë si pasojë e kërkesave të bëra subjektet për zëvendësimin dhe heqjen dorë të trupit gjykues, pasi kishte papajtueshmëri në gjykimin e kësaj çështjeje.

7.3 Kjo çështje është komplekse dhe ekzistojnë rrethana të veçanta të cilat mund të justifikojnë vonesën në gjykim, nisur nga natyra e saj, qëndrim ky i mbajtur edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

8. **Subjekti i interesuar, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT)**, ka parashtruar sa vijon:

8.1 Vendimi i kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 9967/13 datë 14.10.2014, si dhe vendimi nr.

9967/7, datë 1.8.2014, “Për miratimin e lejes zhvillimore ndërtimi” janë nul dhe të pavlefshme, për shkak se janë akte të pabotuara në regjistrin e planifikimit, në kundërshtim me nenin 56/2 të ligjit nr. 107/2014 dhe nenin 53 të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009.

8.2 IKMT-ja është pajisur me informacion për zhvillimin e gjykimeve të çështjeve gjyqësore sipas kronologjisë kohore të tyre nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

## III

## Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

## A. Për legjitimitimin e kërkueses

9. Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese me pretendimin e cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme. Kërkesat e individëve për cenimin e së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm mund të merren në shqyrtim pavarësisht se gjykimi për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore të tyre nuk ka përfunduar ende në të gjitha shkallët e gjykimit prej gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese konstaton se sistemi juridik i vendit nuk parashikon ndonjë mjet juridik të veçantë të cilin mund ta përdorte kërkuesi për të kërkuar riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit gjyqësor. Një gjë e tillë është konstatuar edhe nga GJEDNJ-ja në vendimin e datës 23.10.2007 në çështjen Gjonboçari kundër Shqipërisë (§.77) në të cilin është shprehur se sistemi juridik shqiptar nuk parashikon një mjet të veçantë juridik të cilin kërkuesi mund ta përdorë për riparimin e zgjatjes së tepruar të procesit. Të njëjtën gjë GJEDNJ-ja e ka konstatuar edhe në vendimet në çështjet Marini kundër Shqipërisë të datës 7.7.2008 (§. 154), si dhe Hamzaraj kundër Shqipërisë të datës 3.2.2009 (§.30). Në këtë kuptim, kërkuesja, shoqëria “Gener 2” sh.p.k., legjitimohet për paraqitjen e kësaj kërkesë.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mos gjykimit brenda një afati të arsyeshëm

10. Kërkuesja pretendon se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosshqyrtimit të çështjes së saj gjyqësore brenda



afateve ligjore, të cilat vetë ligji i ka parashikuar të jenë të shpejta e të arsyeshme.

11. Sipas nenit 42 të Kushtetutës kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata pretendimet e kërkuases lidhur me tejzgjatjen e gjykimit i shqyrton nën dritën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, të reflektuara edhe në praktikën e saj, pra referuar rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e saj, sjelljen e kërkuasit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuasin kjo tejzgjatje.

*i) Periudha që duhet marrë në konsideratë*

13. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuases për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me periudhën nga data 8.9.2015, kur dosja është regjistruar në Gjykatën e Apelit Administrativ, e në vijim. Sipas saj, zgjatja e gjykimit tej afatit të arsyeshëm ka ardhur si rrjedhojë e moszbatimit të dispozitave të ligjit nr. 49/2012.

*ii) Kompleksiteti i çështjes*

14. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 14, datë 15.4.2010; nr. 9, datë 14.2.2014; nr. 14, datë 10.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës

administrative (konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit të kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 9967/7, datë 1.8.2014, “Për miratimin e lejes zhvillimore ndërtimi” për strukturë banimi dhe shërbimesh 1 deri 17 kate, si dhe dokumentet e vendimet tjera të lejes përkatëse etj.), gjykimi i së cilës parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Nga shqyrtimi i akteve të paraqitura Gjykata vlerëson se çështja konkrete nuk paraqet rrethana të veçanta apo komplekse që mund të justifikojnë një vonesë në shqyrtimin e saj, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe kërkuases është me rëndësi në këtë kontekst.

*iii) Interesi dhe sjellja e kërkuasit*

16. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuasit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata vëren se kërkuasja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

*iv) Sjellja e autoriteteve*

17. Gjykata, ndër të tjera, është shprehur se në këndvështrim të respektimit të standardeve për një proces të rregullt ligjor gjykatat kanë për detyrë të evitojnë çdo vonesë të panevojshme në procesin gjyqësor (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012; nr. 14 datë 10.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Bazuar në aktet e dosjes gjyqësore rezulton se çështja objekt shqyrtimi ishte planifikuar për t’u gjykuar në seancë gjyqësore në datën 11.5.2016. Janë zhvilluar disa seanca gjyqësore me shtyrje pa u kryer veprime, përkatësisht në datat 13.5.2015, 19.5.2015 dhe 25.5.2016, por aktualisht dosja nuk është shqyrtuar, ndonëse ishte planifikuar për t’u gjykuar dhe ishte ndryshuar relatori i kësaj çështjeje pas kërkesave të bëra nga kërkuasja.

19. Gjykata vëren se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar, ndër parimet e gjykimit administrativ, edhe sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësimit në krijimin e këtyre gjykatave, çka rezulton edhe nga relacioni bashkëlidhur tij, sipas të cilit ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e



mosmarrëveshjeve administrative, si dhe garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata vëren, gjithashtu, se ligji nr. 49/2012 ka parashikuar afate konkrete për gjykimin në të tria shkallët e gjykimit. Për sa i takon procesit që zhvillohet në shkallë të parë, në fazën e veprimeve përgatitore ligji ka parashikuar një afat 7-ditor për kryerjen e disa veprimeve nga ana e gjyqtarit të çështjes (neni 25), afatin për zhvillimin e seancës gjyqësore, i cili nuk mund të jetë më shumë se 15 ditë (neni 27), si edhe afatin 7-ditor për dorëzimin e dosjes pas shpalljes së vendimit (neni 42).

20. Për sa më sipër, Gjykata thekson se përderisa ligjvënësi ka vendosur afate kohore të caktuara (30 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato jo vetëm si afate të arsyeshme, por edhe të detyrueshme për zbatim nga gjykatat administrative të të gjitha shkallëve të gjykimit. Pengesat e mundshme objektive duhet të gjejnë zgjidhje nëpërmjet rregullimit që duhet të bëjë ligjvënësi.

21. Mosrespektimi i këtyre afateve ligjore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, duke sjellë mosgjykimin e çështjes gjyqësore të vënë në lëvizje nga kërkuesja brenda një afati të arsyeshëm, ka cenuar të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt ligjor.

22. Gjykata në rastin konkret nuk konstaton arsye objektive të cilat justifikojnë mosgjykimin brenda afateve ligjore. Për rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkueses është i bazuar dhe duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimin të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo  
Anëtarë kundër: Vitore Tusha, Altina Xhoxhaj

#### MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues shoqërinë “Gener 2” sh.p.k. nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për pranimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimin të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë brenda një afati të arsyeshëm.

2. Neni 131/f i Kushtetutës parashikon se individ mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ka shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Sipas kuptimit të nenit 131/f të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelimeve (*shih vendimin nr. 10, datë 9.5.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Shterimi i mjeteve të ankimit në gjykatat e zakonshme është një kusht, i cili bën të mundur juridiksionin kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt. Në këtë mënyrë, ky rregull përbën një aspekt të rëndësishëm të parimit se procedura e zgjidhjes së ankesave individuale përpara Gjykatës Kushtetuese është plotësuese e gjykimin në gjykatat e zakonshme lidhur me mbrojtjen e të drejtave kushtetuese (parimi i subsidiaritetit) (*shih vendimin nr. 23, datë 4.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Çështja e shterimit të mjeteve juridike përbën kusht paraprak që duhet përmbushur nga kërkuesi, që do të thotë se individ përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton se kërkuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat



janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimin nr. 17, datë - 16.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Vetëm pasi individët të kenë konsumuar edhe shkallën e fundit të kontrollit gjyqësor të zakonshëm, këto vendime mund të kontrollohen nga Gjykata Kushtetuese nga pikëpamja e kushtetutshmërisë së tyre. Mbi këtë bazë bëhen objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese ato çështje gjyqësore të paraqitura nga individët për shkeljen e të drejtave të tyre, pasi vendimi i gjykatës ka marrë formë të prerë dhe nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

4. Kërkuesi duhet të provojë para Gjykatës, në aspektin e shterimit të mjeteve, se nuk ka mjet tjetër ankimi ndaj shkeljeve të pretenduara dhe se shqyrtimi gjyqësor nuk mund t'i ndreqë këto shkelje. Në rrethana të tilla është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë, sipas karakterit të çështjes konkrete dhe llojit të shkeljeve të pretenduara, nëse kërkuesi i ka shteruar ose jo të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara.

5. Në kuptim të sa më sipër, në linjë edhe me qëndrimet e tjera në pakicë në çështje të së njëjtës natyrë, edhe në rastin konkret vlerësoj se kërkuësja nuk duhej të ishte legjitimuar për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kushtet kur çështja administrative e vënë në lëvizje prej saj është ende në shqyrtim në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe nuk ka një vendim gjyqësor përfundimtar. Siç e kam theksuar edhe më parë, një qëndrim i tillë i Gjykatës për pranimin e këtyre lloj kërkesash pa përfunduar procesi gjyqësor, sjell si pasojë që i njëjti individ t'i drejtohet Gjykatës disa herë brenda të njëjtit proces gjyqësor, veçmas për çdo pretendim për zvarritje të procesit gjyqësor, në çdo shkallë të tij, dhe më pas, pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe dhënies së një vendimi përfundimtar, edhe për pretendime të tjera që lidhen me të njëjtin proces gjyqësor.

6. Në ndryshim nga shumica, ritheksoj se individët gëzojnë të gjitha garancitë procedurale nga sistemi ligjor për rivendosjen në vend të të drejtave të tyre para se t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese. Pretendimet që kërkuesi ka ngritur para Gjykatës nuk janë të tilla që t'i shmangen kontrollit të mëtejshëm gjyqësor, pasi një pretendim i tillë mund të paraqitet lirisht jo vetëm para gjykatës që shqyrton çështjen, por edhe në

gjykatat më të larta si shkak për ankim.

7. Për të gjitha argumentet e mësipërme, vlerësoj se kërkuësja, shoqëria “Gener 2” sh.p.k., nuk ka shteruar mjetet ligjore për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në respektim të nenit 131/f të Kushtetutës.

Anëtare: Vitore Tusha

## VENDIM

Nr. 23, datë 20.3.2017

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.2.2017 dhe 21.2.2017, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 89/25 Akti që i përket:

KËRKUES: Vjollca Mema, Matilda Hazizaj, Maltin Mema

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Sajmir Peko, Bashkia Sarandë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Sarandë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-2817, datë 15.7.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 72 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

### GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Gani Dizdari, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësve, që kërkuan pranimin e kërkesës dhe pretendimet me shkrim të subjektit të interesuar Sajmir Peko, që kërkoji rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,





## VËREN:

## I

1. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se kërkuesit janë trashëgimtarë të shtetasit Petrit Mema. Me vendimin nr. 1, datë 28.8.1999 të Këshillit Bashkiak Sarandë, midis të tjerave, atij i është dhënë për ndërtim parcela nr. 4 në bllokun H4 me sipërfaqe 914 m<sup>2</sup> së bashku me lejen e ndërtimit.

2. Petrit Mema, pasi është vënë në dijeni se kjo sipërfaqe është regjistruar në emër të subjektit të interesuar, Sajmir Peko, i është drejtuar gjykatës me padi me të cilën kërkon deklarimin e pavërtetë të vendimit nr. 1, datë 28.8.1999 të Këshillit të Bashkisë Sarandë vetëm për subjektin Sajmir Peko, duke pretenduar se në këtë vendim këshilli është shprehur vetëm për bllokun H4, parcela nr. 4 që i takon Petrit Memës dhe si pasojë kërkon pavlefshmërinë absolute të të gjitha veprimeve që subjekti Sajmir Peko ka kryer me organet e pushtetit lokal për këtë parcelë dhe fshirjen nga regjistri hipotekor të kësaj pasurie.

3. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar Sajmir Peko ka paraqitur kundërpadi për pavërtetësi dhe goditje për falsitet të të gjitha akteve administrative në emër të paditësit Petrit Mema, të nxjerra në funksion të parcelës nr. 4 blloku H4, duke pretenduar se është pronari i vetëm i kësaj parcele.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr. 23-2011-1021(639), datë 16.5.2011, ka vendosur: *“Pranimin e padisë. Deklarimin pjesërisht të pavërtetë të vendimit nr. 1, datë 28.8.1999 të Këshillit Bashkiak Sarandë për sa i përket të paditurit/ kundërpaditës Sajmir Peko. Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes me nr. 1629 rep., nr. 785 kol., datë 1.9.2000 të lidhur midis shitësit Bashkia Sarandë dhe blerësit Sajmir Peko dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Fshirjen nga regjistri hipotekor të kësaj sipërfaqeje prej 914 m<sup>2</sup> të regjistruar në emër të Sajmir Peko në regjistrin nr. 1, faqe 38, nr. 112 indeksi, datë 2.4.2001. Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke detyruar të paditurin/ kundërpaditës të mos tjetërsojë këtë pasuri të të tretët. Rrëzimin e kundërpadisë së të paditurit/ kundërpaditës Sajmir Peko si të pabazuar në prova e në ligj.”*

5. Gjykata e Apelit Gjyrokastër, me vendimin nr. 558, datë 16.12.2011, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 23-2011-1021 (639), datë 16.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.”*

6. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs pala e paditur kundërpaditëse Sajmir Peko. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-2817 (356), datë 15.7.2015, ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 558, datë 16.12.2011 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe vendimit nr. 639, datë 16.5.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, si më poshtë: ‘Rrëzimin e padisë së Vjollca Mema, Matilda Hazizaj (Mema) dhe Maltin Mema kundër të paditurit kundërpaditës Sajmir Peko. Pranimin e padisë së të paditurit kundërpaditës Sajmir Peko, duke i deklaruar të pavërteta aktet e përmendura në objektin e kundërpadisë, dhe kërkimeve të tjera.’”*

## II

7. **Kërkuesit** i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të saj, duke pretenduar se gjykimi në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë është zhvilluar pa praninë e tyre dhe për këtë shkak është cenuar procesi i rregullt ligjor, pasi nuk u është dhënë mundësia të dëgjohen nga gjykata.

8. **Subjekti i interesuar Sajmir Peko** ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke parashtruar se pretendimi është i pabazuar, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i ka bërë të gjitha përpjekjet për t'u mundësuar kërkuesve marrjen pjesë në seancën gjyqësore të caktuar prej tij. Ai Kolegji e ka shtyrë 3 herë datën e gjykimit, ndërkohë që kërkuesit nuk kanë treguar predispozitë dhe gatishmëri për të marrë pjesë në gjykim, duke gjetur shkaqe të reja për çdo seancë. Gjykimi i rekursit në Gjykatën e Lartë nuk bëhet sipas nenit 175 të Kodit të Procedurës Penale (KPC), por sipas nenit 483 të KPC-së, sipas të cilit mbrojtja dhe përfaqësimi bëhet nga avokati. Kërkuesit asnjëherë nuk kanë pretenduar para gjykatës se nuk kanë mundësi të marrin avokat, prandaj detyrimi për të siguruar pjesëmarrjen e vet në seancë u mbetet kërkuesve.

## III

## Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

## A. Për legjitimitimin e kërkuesve

9. Gjykata vëren se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit të parashikuar nga neni 31 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.



10. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar në mënyrë të vazhdueshme se kontrolli që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor, kurse problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimin nr. 62, datë 23.9.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

*B. Për pretendimin e zhvillimit të gjykimit në mungesë në Gjykatën e Lartë*

11. Gjykata ka vlerësuar se e drejta e palëve për të qenë të pranishme, për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar në procesin gjyqësor janë aspekte të rëndësishme të procesit të rregullt në kuptimin kushtetues. Në nenin 42/2 të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje

përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesit në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës (*shih vendimin nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në lidhje me çështjen në shqyrtim, nga materialet bashkëlidhur të kërkesës, rezulton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 1.7.2015, mbështetur në nenin 199/1 të KPC-së, si dhe në kërkesën e njërit prej subjekteve të interesuara, Matilda Hazizaj (Mema), bëri zëvendësimin procedural të shtetasit Petrit Mema me trashëgimtarët ligjorë të tij. Ky zëvendësim procedural u bë duke iu referuar dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. 1067 prot., nr. 430 kol, datë 4.6.2015, sipas së cilës rezulton se shtetasi Petrit Mema ka ndërruar jetë. Për këtë arsye Kolegji Civil thirrri në gjykim si palë paditëse të kundërpaditur trashëgimtarët ligjorë të tij, Vjollca Mema (bashkëshortja), Matilda Hazizaj (Mema) (e bija) dhe Maltin Mema (i biri), të cilët janë kërkues në këtë gjykim.

13. Po kështu nga dosja gjyqësore konstatohet se seanca gjyqësore e Kolegjit Civil është shtyrë disa herë për shkaqe, të tilla si: çelja e trashëgimisë së subjektit të interesuar Petrit Mema, për të cilën seanca u shty dy herë (datë 10.6.2015 dhe datë 1.7.2015), pasi trashëgimlënësit kërkuan kohë për shkak të mosrealizimit të çeljes së trashëgimisë para noterit. Njoftimi për seancën e radhës është bërë nga Kancelari i Gjykatës së Lartë, sipas rregullave, gjë që pranohet edhe nga kërkuesja. Në seancën e datës 1.7.2015 është bërë zëvendësimi procedural dhe seanca është riçelur sërish në datën 15.7.2015, me qëllim marrjen pjesë edhe të trashëgimtarëve të tjerë. Një prej trashëgimtarëve, M.H., i pranishëm në seancë ka marrë dëgjimin për datën dhe orën e zhvillimit të seancës tjetër dhe ka marrë përsipër para gjykatës të njoftojë trashëgimtarët e tjerë (e regjistruar në procesverbal). Në datën 14.7.2015, trashëgimtarja M.H., e cila kishte marrë përsipër njoftimin e kërkuesve të tjerë, ka kërkuar shtyrjen e seancës për shkaqe shëndetësore. Ndërkohë personat e tjerë (kërkuesit) nuk kanë paraqitur asnjë



shkak për mospjesëmarrjen në seancë. Në këto kushte, Kolegji Civil ka vendosur vazhdimin e gjykimit të çështjes pa praninë e tyre.

14. Gjykata, pas shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, vëren se pretendimi i ngritur nga kërkuesja nuk arriti të merrte shumicën e votave të gjyqtarëve prej 5 anëtarësh të kërkuar nga ligji. Sipas nenit 72/2 të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj. Në votimin për këtë çështje 4 gjyqtarë votuan për rrëzimin e kërkesës dhe 3 për pranimin e saj.<sup>4</sup> Nisur nga ky fakt, bazuar në nenin 73 të këtij ligji, për shkak të mosformimit të shumicës prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 70, 72 dhe 73 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Fatos Lulo

#### VENDIM

Nr. 24, datë 23.3.2017

#### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datat 28.2.2017 dhe 7.3.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, me dyer të hapura, çështjen me nr. 4 Akti, që u përket palëve:

**KËRKUES:** Elvis Rroshi, përfaqësuar nga z. Theodhori Sollaku dhe z. Viktor Gumi, me prokurë.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:** Kuvendi i Shqipërisë, përfaqësuar me autorizim nga z. Alban Brati;

Këshilli i Ministrave, përfaqësuar me autorizim në gjykim nga z. Artur Metani;

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfaqësuar me autorizim në gjykim nga znj. Dëshira Pasko;

Prokuroria e Përgjithshme, përfaqësuar me autorizim në gjykim nga z. Arqile Koça.

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i nenit 2/1/a, nenit 2/2, nenit 4, pikat 1, 5, 6 dhe 7, i fjalëve “moszgjedhje” në nenin 10 dhe i shkronjës “d”, neneve 14 dhe neni 15 për funksionarin publik kryetar i bashkisë, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 952, datë 29.12.2016, “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, zoti Elvis Rroshi”.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 174, datë 29.12.2016, “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik, z. Elvis Rroshi, Kryetar i Bashkisë Kavajë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

<sup>4</sup> Votuan për pranimin e kërkesës gjyqtarët: Bashkim Dedja, Vladimir Kristo dhe Vitore Tusha. Votuan për rrëzimin e kërkesës gjyqtarët: Fatmir Hoxha, Gani Dizdari, Besnik Imeraj dhe Fatos Lulo.



Shqyrtimi i kushtetutshmërisë së të gjithë ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZA LIGJORE: Nenet 6/1, 29, 115 dhe 134/1/i të Kushtetutës; neni 71, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

## GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Gani Dizdari, shqyrtoi pretendimet e kërkuetit, që kërkonte pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Kuvendit të Shqipërisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Këshillit të Ministrave, që kërkon rrëzimin e kërkesës dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që ia la në çmim Gjykatës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

### I

1. Kërkueti është zgjedhur kryetar i Bashkisë Kavajë në zgjedhjet vendore të mbajtura në qershor të vitit 2015.

2. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me vendimin nr. 174, datë 29.12.2016 (174/2016), “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik, z. Elvis Roshi, Kryetar i Bashkisë Kavajë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, ka vendosur: “*Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundim të parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, z. Elvis Roshi. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar me procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës.*”

3. Këshilli i Ministrave (KM) në datën 29.12.2016 miratoi vendimin nr. 952, datë 29.12.2016 (952/2016), “Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, zoti Elvis Roshi”, me të cilin vendosi: “*Shkarkimin nga detyra për shkak të shkeljeve të rënda të ligjit të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, zoti Elvis Roshi.*”

4. Në datën 09.06.2016 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. 4810 ndaj shtetasit Elvis Roshi për veprën penale të falsifikimit të vulave, stampave dhe formularëve, parashikuar nga neni 190/1 i Kodit Penal (KP). Hetimet vazhdojnë ende.

Faqe | 3434

## II

5. Kërkueti i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) sipas objektit të saj, ku ka disa kërtime, të përmbledhura si më poshtë:

5.1 Në lidhje me shfuqizimin e vendimit të KM-së, kërkueti pretendon se:

5.1.1 Vendimi i KM-së për shkarkimin e kërkuetit nuk përmban shkaqe ligjore konkrete, por i referohet vendimit të KQZ-së, ndërkohë që ky i fundit i referohet shkresës së Prokurorisë së Përgjithshme (PP). Sipas kësaj të fundit, mandati i kërkuetit duhet të ndërpritet për shkak të ligjit nr. 138/2015, sipas të cilit çdo lloj krimi apo kundërvajtje penale passjell ndalim të ushtrimit të funksionit publik përjetë. Pra, akti i shkarkimit nga ana e KM-së dhe e KQZ-së mbështetet në një ligj antikushtetues, pasi nuk respekton asnjë standard kombëtar dhe ndërkombëtar për kufizimin e të drejtave themelore.

5.1.2 Vendimi i KM-së ka marrë të mirëqenë ekzistencën e akteve të përmendura në shkresën e PP-së (masa e sigurimit personal dhe dëbimit), duke u dhënë atyre fuqi të plotë provuese. Ndërkohë, as masa e sigurimit personal, as ajo e dëbimit nuk mund të barazohen me fajësinë, e kundërta do të thotë cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë. Po kështu edhe procedimi penal për falsifikim të vulave, stampave dhe formularëve nuk ka përfunduar në ndonjë vendim fajësie apo rezultat tjetër që shkon në favor të vërtetimit të shkeljes së ligjit nga kërkueti. Edhe ky veprim cenon parimin e prezumimit të pafajësisë.

5.2 Në lidhje me shfuqizimin e vendimit të KQZ-së, kërkueti pretendon se:

5.2.1. Vendimi i marrë nga KQZ-ja është tejet i ashpër, për shkak të ashpërsisë së ligjit nr. 138/2015 ku ai bazohet, duke e shndërruar pasojën që sjell në një dënim penal, gjë që nuk është në pajtim me përmbajtjen e vetë ligjit nr. 138/2015 dhe të Kushtetutës. Dënimi penal parashikohet vetëm në KP për vepra të përfshira në të.

5.2.2 Vendimi i KQZ-së është antikushtetues, pasi nuk është shoqëruar as me vendimin penal të dhënë nga gjykata italiane, siç pretendohet nga shkresa e PP-së, as me dekretin e dëbimit të kërkuetit nga autoritetet italiane. Madje këto akte nuk i janë vënë asnjëherë në dijeni kërkuetit. Mosadministrimi në dosje i vendimit penal dhe aktit të dëbimit është shkelje flagrante e ligjit dhe e



Kushtetutës, që e bën aktin e shkarkimit të pavlefshëm. E njëjta gjë vlen edhe për masën e ndalimit personal dhe urdhrin e kërkimit ndërkombëtar.

5.2.3 Vendimi i KQZ-së ka marrë të mirëqenë ekzistencën e akteve, duke u dhënë atyre fuqi të plotë provuese. Ndërkohë, as masa e sigurimit personal, as ajo e dëbimit nuk mund të barazohen me fajësinë, e kundërta do të thotë cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë.

5.3 *Në lidhje me shfuqizimin e ligjit nr. 138/2015, kërkuesi pretendon se:*

5.3.1 Ligji i kundërshtuar cenon parimin e sigurisë juridike, pasi u jep fuqi prapavepruese veprave të kryera para marrjes së funksionit nga ana e personave që zgjidhen ose emërohen, duke sjellë si pasojë cenimin e pritshmërive të ligjshme. Në momentin e zgjedhjes së kërkuesit kryetar bashkie ndalimet e parashikuara në ligjin nr. 138/2015 nuk kanë qenë të parashikuara, pra janë shtuar rastet e ndalimit të marrjes së funksionit pasi ai ka filluar të ushtrijë detyrën. Në këto kushte individit është vënë në pamundësi të shmangies së këtyre ndalimeve shtesë. Për këtë arsye, ky ligj bie ndesh me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

5.3.2 Ligji parashikon se kur verifikohen kushtet për moskandidim ose moszgjedhje mandati shpallet i pavlefshëm. Koncepti i “shpalljes së pavlefshmërisë së mandatit” është i panjohur nga Kushtetuta në pjesën e qeverisjes vendore apo nga ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

5.3.3 Baza kushtetuese për shkarkimin e kryetarit të bashkisë lidhet vetëm me mënyrën e kryerjes së detyrave dhe zbatimit të detyrimeve ligjore të tij në ushtrimin e mandatit dhe kompetencave të kryetarit të bashkisë dhe nuk i referohet asnjë sjelljeje apo gjendjeje të mëparshme të tij para se të marrë postin. Shkaqet e ndërprerjes së mandatit për organet e qeverisjes vendore janë të parashikuara nenin 115 të Kushtetutës dhe nenet 61 dhe 62 të ligjit, “Për vetëqeverisjen vendore”.

5.3.4 Ligji nuk respekton asnjë kriter të parimit të proporcionalitetit, të parashikuar nga neni 17 i Kushtetutës. Veçanërisht balancimi i interesave të prekur dhe atyre të mbrojtur nuk rezulton të jetë respektuar nga ligji objekt kërkese. Ndalimi i pakufizuar, pra përjetë, për të

kandiduar është në tejkalim të parimit të proporcionalitetit, pasi është mjaft i ashpër. Si rrjedhim, ky ndalim cenon të drejtën për t’u zgjedhur si e drejtë themelore në një demokraci.

5.3.5 Neni 2/2 i ligjit nr. 138/2015 bie ndesh me nenin 45/3 të Kushtetutës, pasi kapërcen parashikimet e këtij të fundit, duke përfshirë si shkak të mbarimit të mandatit, përveç vendimit gjyqësor të formës së prerë, edhe dënimin me vendim jopërfundimtar, si dhe masat e vendosura për sigurimin personal apo kur ndaj tij është lëshuar një urdher kërkimi ndërkombëtar, si dhe ata që janë dëbuar nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-së, Kanadasë, Australisë për vepra të parashikuara në ligj. Kjo gjë cenon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke mosrespektuar parimin e proporcionalitetit dhe atë të hierarkisë së akteve, parashikuar nga neni 116 i Kushtetutës.

6. **Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë**, ka parashtruar si vijon:

6.1 Kërkuesi nuk mund t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke e bazuar kërkesën e tij te neni 115 i Kushtetutës, por te neni 131/e i saj. Arsyeja për këtë është se nuk ndodhemi para rastit të shkarkimit të një organi të qeverisjes vendore, por të mbarimit të mandatit për shkak se lidhet me zgjedhshmërinë e kërkuesit dhe jo me shkelje të bëra gjatë detyrës. Vendimi i KM-së është marrë mbi bazë të vendimit të KQZ-së dhe jo për shkak të shkeljeve të kryera nga kërkuesi gjatë ushtrimit të detyrës.

6.2 Lidhur me kërkesën për shfuqizimin e disa dispozitave të ligjit nr. 138/2015 jemi të qëndrimit se sanksioni ligjor i parashikuar për përfundimin para kohe të mandatit nuk është sanksion penal dhe respekton tërësisht parimin e proporcionalitetit në kufizimin e një të drejte themelore siç është e drejta për t’u zgjedhur.

7. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme**, ka parashtruar si vijon:

7.1 Nuk qëndron pretendimi i kërkuesit se PP-ja nuk ka kryer hetim të plotë dhe nuk ka administruar vendimet e dënimit. Ky institucion i është drejtuar Zyrës Ndërlidhëse të Italisë nëpërmjet Zyrës Kombëtare Europol, e cila ka konfirmuar dënimin për përdhunim në vitin 1995 dhe lëshimin në të njëjtën ditë të dekretit për ekspulsë (dëbim). Po kështu, edhe Zyra Ndërlidhëse e Zvicrës ka konfirmuar se në vitin 1993 kërkuesi është ndaluar për një rast droge dhe



është dëbuar 4 muaj më vonë. Gjithashtu, ai është dëbuar sërish në vitin 1997 nga Zvicra. Po kështu, në vitin 2015 DEA/US ka informuar autoritetet zvicerane se po hetonin shtetasin Enver Rroshi (emër i mbajtur dhe i përdorur nga kërkuesi) për trafik droge dhe pastrim parash, por nuk kishin detaje të mëtejshme. Të gjitha këto janë vepra të parashikuara nga neni 2/ 2/b i ligjit nr. 138/2015. PP-ja ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore me qëllim verifikimin e kritereve dhe të kushteve që parashikon ligji nr. 138/2015.

7.2 Gjithashtu, institucioni i PP-së ka nisur procedimin penal në ngarkim të shtetasit Elvis Rroshi për veprën penale të falsifikimit të vulave, stampave dhe formularëve, parashikuar nga neni 190/1 të KP-së, pasi ai nuk i ka deklaruar vendimet dhe aktet e parashtruara më sipër.

7.3 Nuk qëndron edhe pretendimi se PP-ja nuk i ka vënë në dispozicion kërkuesit kopje të vendimeve dhe akteve të mbledhura gjatë procesit të verifikimit sipas ligjit nr. 138/2015. Ky ligj nuk parashikon detyrimin e organeve të verifikimit për t'i njohur subjektet me kopje të akteve të mbledhura.

7.4 Për sa i takon pretendimit të kërkuesit për antikushtetutshmërinë e ligjit nr. 138/2015, mendojmë se bazueshmëria e tij në standardet kushtetuese nuk mund të vihet në dyshim as organi i PP-së, as nga kërkuesi. Bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës këtë të drejtë e kanë vetëm gjykatat, të cilat gjatë zbatimit të ligjit mund të pezullojnë çështjen dhe t'ia dërgojnë për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese.

8. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave,** ka paraqitur prapësime me shkrim, duke argumentuar si vijon:

8.1 Nuk qëndron pretendimi i kërkuesit se vendimi nr. 952/2016 nuk ka respektuar kriteret kushtetuese, pasi nuk është i mbështetur në shkaqe dhe argumente ligjorë. KM-ja, si organ kompetent në bazë të nenit 115 të Kushtetutës, ka konstatuar se kërkuesi kishte kryer shkelje të ligjit, bazuar në ligjin 138/2015, fakt ky i konstatuar nga PP-ja dhe KQZ-ja. Bazuar në këtë konstatim KM-ja vendosi shkarkimin e kërkuesit.

8.2. Nuk qëndron as pretendimi se vendimi i KM-së është një vendim i natyrës penale dhe si i tillë nuk mund të merret në kushtet e mosvërtetimit të faktit. KM-ja si organ i qeverisjes qendrore ka detyrimin të garantojë besimin e publikut te organet

publike. Besimi publik i zyrtarit cenohet edhe kur vepra penale është kryer para marrjes së detyrës ose funksionit. Sa më e rëndë të jetë shkelja, aq më i rëndë është cenimi e për rrjedhojë në proporcion me to duhet të jetë edhe masa mbrojtëse për organin përkatës.

9. **Subjekti i interesuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,** ka parashtruar si vijon:

9.1 Vendimi i këtij institucioni është marrë në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 138/2015. Prokurori i Përgjithshëm, me shkresën nr. 2436, datë 11.05.2016, i kërkoi KQZ-së verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit të z. Elvis Rroshi. Pas verifikimit PP-ja ia dërgoi rezultatin KQZ-së. Kjo e fundit kreu hetim të plotë administrativ dhe në përfundim të tij vendosi shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kërkuesit.

9.2. Për sa i takon kushtetutshmërisë së ligjit nr. 138/2015, pavarësisht se nuk jemi organ kompetent për ta kërkuar, por nisur nga problemet e hasura gjatë zbatimit të këtij ligji, i sugjerojmë Gjykatës që të ofrojë një interpretim kushtetues të këtij ligji.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Për legjitimitimin e kërkuesit dhe juridiksionin e Gjykatës*

a) *Për kundërshtimin e vendimit nr. 952/2016 të KM-së*

10. Kërkuesi kundërshton vendimin nr. 952/2016 të KM-së, duke pretenduar se është shkarkuar nga detyra e kryetarit të Bashkisë Kavajë në mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 115/1 i Kushtetutës, pasi ai nuk ka kryer sjellje dhe akte që bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjin gjatë ushtrimit të detyrës.

11. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se vendimi për shkarkimin nga detyra të organit të qeverisjes vendore është një akt individual i natyrës administrative. Në rastin e shkarkimit nga detyra të organit të qeverisjes vendore, kushtetutbërësi, në mënyrë që t'u japë garanci më të mëdha në ushtrimin e detyrës këtyre organeve, në nenin 115/2 të Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e tyre për t'u ankuar drejtpërdrejt në Gjykatën Kushtetuese, si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit Gjykata shqyrton



drejtpërdrejt vetëm kushtetutshmërinë e akteve me karakter normativ (*shih vendimet nr. 67, datë 11.11.2016; nr. 32, datë 10.7.2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, nisur nga praktika e vazhdueshme e kësaj Gjykate, kërkuesi legjitimohet prima facia t'i drejtohet Gjykatës, nëse shkarkohet nga KM-ja për shkelje të ligjit, sipas nenit 115/2 të Kushtetutës.

12. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, bazuar në nenin 115/2 të Kushtetutës, organi i shkarkuar mund të ankohet brenda 15 ditëve në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata është shprehur se si datë e fillimit të afatit të ankimit ndaj aktit individual, që cenon të drejtat e personit, do të konsiderohet data e marrjes djeheni nga personi për ekzistencën e aktit, pavarësisht formave të tjera të publikimit (*shih vendimin nr. 67, datë 11.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Rezulton se vendimi i KM-së, "Për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, zoti Elvis Rroshi" është kundërshtuar nga kërkuesi në datën 9.1.2017, pra brenda afatit 15-ditor të parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës. Për këtë arsye kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* për kundërshtimin e vendimit të KM-së.

13. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae* Gjykata vëren se KQZ-ja, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, pas verifikimit të PP-së për funksionarin publik, ka vendosur: "Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, z. Elvis Rroshi. Ky vendim i njoftohet menjëherë Kryeministrit për të vijuar me procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës.". KM-ja me vendimin nr. 952/2016 vendosi: "Shkarkimin nga detyra për shkak të shkeljeve të rënda të ligjit të Kryetarit të Bashkisë Kavajë, zoti Elvis Rroshi.".

14. Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ndodhemi para situatës së parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, sipas të cilit kur në veprimtarinë e organit të zgjedhur drejtpërdrejt të njësisë së qeverisjes vendore konstatohen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve, ai mund të shpërndahet ose të shkarkohet nga KM-ja, por kemi të bëjmë me veprimin e rregullimeve të reja kushtetuese dhe ligjore lidhur me garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike. Konkretisht, neni 179/a i Kushtetutës parashikon: "Mandati i funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar në organet kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, që është situar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbaron ose është i pavlefshëm kur konstatohet se i

zgjedhur ose i emëruari përfshihet në rrethin e subjekteve që janë të përjashtuara nga e drejta për t'u zgjedhur, sipas neneve 6/1 dhe 45, pika 3, të Kushtetutës.". Ndërsa nenet 7/1/a dhe 10/1/d të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" parashikojnë se kërkesa për verifikimin e figurës së zyrtarëve të zgjedhur ose të emëruar dorëzohet pranë Prokurorisë së Përgjithshme, e cila rezultatet e verifikimit ia dërgon KQZ-së. Kjo e fundit kur verifikon kushtet për moskandidim ose moszgjedhje shpall pavlefshëm e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të tij.

15. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se nuk ndodhet para rastit kur duhet të marrë në shqyrtim kushtetutshmërinë e vendimit të KM-së, pasi vendimi i KM-së nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike për kërkuesin, i cili në momentin e marrjes së këtij vendimi nuk përfaqësonte më asnjë pushtet apo organ të qeverisjes vendore. Mandati i tij ishte shpallur i pavlefshëm dhe kishte përfunduar para kohe si pasojë e vendimmarrjes së KQZ-së, si organi i vetëm që e ka një kompetencë të tillë sipas Kushtetutës dhe ligjit nr. 138/2015.

16. Gjykata vëren se në çështjen konkrete ndërprerja e parakohshme e mandatit të kërkuesit si kryetar i Bashkisë Kavajë nga KQZ-ja ka ardhur pas verifikimit të bërë nga PP-ja lidhur me deklaratimet e bëra nga kërkuesi, në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 138/2015. PP-ja ka verifikuar dhe konstatuar disa fakte, të cilat parashikohen në nenin 2/2 të ligjit nr. 138/2015 si shkaqe për ndërprerjen e mandatit të zyrtarëve të zgjedhur ose të emëruar. Në këto kushte, KQZ-ja ka marrë vendim për përfundimin e parakohshëm të mandatit të kërkuesit. Pra, nuk është KM-ja që de facto dhe de jure i ka dhënë fund mandatit të organit të pushtetit vendor në rastin konkret, por është KQZ-ja dhe për rrjedhojë vetëm kundër vendimit të kësaj të fundit mund të fillojë procedura e ankimit gjyqësor nga kërkuesi në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Një mandat i shpallur i pavlefshëm ose që mbaron para afatit nuk ka nevojë për akte të tjera juridike konstatuese, aq më pak që rezultojnë në shkarkimin e një organi, mandati i të cilit ka përfunduar tashmë.

17. Gjykata e sheh me vend të theksojë gjithashtu se, në rastin e mbarimit të parakohshëm të mandatit, ligji nr. 138/2015 nuk e autorizon KQZ-në që të referojë çështjen te një organ tjetër



kushtetues ose ligjor që të fillojë procedurën e shkarkimit të një organi të zgjedhur ose të emëruar, por vetëm e autorizon KQZ-në që të njoftojë KM-në për përfundimin e mandatit të organit të zgjedhur. Për këtë arsye, togfjalëshi i përdorur në pikën 3 të vendimit të KQZ-së, “Për të vijuar me procedurat e parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës” del tej kompetencave të saj.

18. Gjykata duke vlerësuar rrethanat konkrete të çështjes konstaton se përfundimi i mandatit të kërkuarit si kryetar i Bashkisë Kavajë nuk ka ardhur si pasojë e vendimmarrjes së KM-së, por si pasojë e vendimmarrjes së KQZ-së, bazuar në ligjin nr. 138/2015. Për këtë arsye, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuarit për kundërshtimin e vendimit të KM-së nuk bien në rrethin e çështjeve të parashikuara nga neni 115 i Kushtetutës dhe si të tilla nuk mund të shqyrtohen nga kjo Gjykatë.

b) Për kundërshtimin e vendimit nr. 174/2016 të KQZ-së

19. Gjykata vlerëson se vendimi i KQZ-së i kundërshtuar nga kërkuari është një akt administrativ individual dhe si i tillë ai mund t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Bazuar në nenet 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individit mund t'i drejtohet kësaj Gjykate me anë të një ankimi individual, nëse pretendon se gjatë shqyrtimit gjyqësor i janë cenuar të drejtat e tij themelore që burojnë nga Kushtetuta, vetëm pas shterimit të këtyre mjeteve. Individit, në kuptim të neneve 131/f, 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës, mund ta vërë në lëvizje këtë Gjykatë për çështje që lidhen me interesat e tij, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike, çka nënkupton se kërkuari duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe efikase për një çështje konkrete (*shih vendimet nr. 52, datë 20.7.2015; nr. 85, datë 30.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nisur nga sa më lart, Gjykata çmon se kërkuari nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe për këtë arsye ai nuk legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate.

c) Për kundërshtimin e ligjit nr. 138/2015

21. Në lidhje me legjitimitimin e kërkuarit për kundërshtimin e dispozitave të ligjit nr. 138/2015, Gjykata çmon se ai nuk legjitimohet *rationae personae*. Gjykata thekson se e drejta për të bërë një

ankim kushtetues individual, sipas neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, mund të ushtrohet vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe vetëm nëse vërtetohet interesi i drejtpërdrejt i kërkuarit, sipas nenit 134/2 të Kushtetutës. Nisur nga parashtrimet e vetë kërkuarit, por edhe të subjekteve të interesuara, Kuvendit, KQZ-së dhe KM-së, Gjykata vlerëson se kërkuari nuk legjitimohet të kërkojë shfuqizimin e ligjit nr. 138/2015. Ai duhet të përdorë mjetet juridike në dispozicion për të kundërshtuar aktet individuale të dala në zbatim të ligjit që ai pretendon si antikushtetues dhe vetëm pasi të ketë shteruar rrugët gjyqësore, nëse kërkuari pretendon se i janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore, atëherë ai mund t'i drejtohet kësaj Gjykate.

22. Si përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuari nuk mund të pranohet, pasi ai nuk legjitimohet për vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për kundërshtimin e vendimit nr. 952/2016 të KM-së, të vendimit nr. 174/2016 të KQZ-së, si dhe të ligjit nr. 138/2015.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 70 e në vijim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri

#### VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari, Fatos Lulo



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa:  
Bulevardi “Gjergj Fishta”  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”  
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 196 lekë